

KOMPANIA: "Kijeva Group BSV" Sh.p.k.  
ZK. Kijevë komuna Malishevë

RAPORT  
I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS



Investitori/kompania: „Kijeva Group BSV” Shpk

Lloi i Objektit: Objekt afarist pompë derivatesh me etazhet P+0

Kapaciteti i rezervarve: R1 = 13 600; R2 = 16 000; dhe R3 = 40 000  
**litra**

Ngastra kadastrale: P-72310037-00131-1 dhe P-72310037-00130-3

Zona kadastrale: **Kijevë**

Komuna: **Malishevë**

Aplikuesi i projektit: „Kijeva Group BSV” Shpk; z. Besim Ukaj

Janar 2024

**Investitori/Kompania: „Kijeva Group BSV” Shpk**

**Aplikuesi; z. Besim Ukaj, drejtor**

\_\_\_\_\_ **v.v.**

**Hartuesi i Raportit:**

**Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati,**

\_\_\_\_\_  
**Nr. i licencës: 71/17**

**[edonak88@gmail.com](mailto:edonak88@gmail.com)**

**+383 49 521 528**

**Janar 2024**

## Përmbajtja

|                                                                                         |    |
|-----------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1. HYRJE .....                                                                          | 5  |
| 2. BAZA LIGJORE E PËRPILIMIT TË RAPORTIT TË VNM-së .....                                | 6  |
| 2.1. Rregullativa Ligjore .....                                                         | 7  |
| 2.2. Metodologjia e Punës .....                                                         | 9  |
| 3.0. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT .....                                         | 10 |
| <b>3.3. Pozita gjeografike e komunës së Malishevës</b> .....                            | 16 |
| 3.7 Rrjeti ekologjik .....                                                              | 19 |
| 3.8. Popullsia .....                                                                    | 20 |
| 3.9. Infrastruktura ekzistuese .....                                                    | 21 |
| 3.10. Biodiversiteti .....                                                              | 24 |
| <b>3.12. Flora dhe Fauna</b> .....                                                      | 25 |
| 3.13. Karakteristikat sizmike .....                                                     | 26 |
| 3.14. Efektet vizuale .....                                                             | 26 |
| 3.15. Ajri .....                                                                        | 27 |
| 4. PROCESI TEKNOLOGJIK .....                                                            | 27 |
| 4.1. Përshkrimi i pajimeve dhe objekteve ndërtimore .....                               | 27 |
| 4.2. Objekti i administratës .....                                                      | 28 |
| 4.3. Platoja e kompleksit .....                                                         | 29 |
| 4.4. Rezervarët e lëndëve djegëse të lëngëta (naftë dhe benzinë) .....                  | 29 |
| 4.6. Karakteristikat kryesore të procesit teknologjik në stacionin e karburanteve ..... | 31 |
| 4.7. Komponentët hyrëse në procesin teknologjik .....                                   | 32 |
| 4.8. Komponentët dalëse në procesin teknologjik .....                                   | 33 |
| 5. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis .....                                                 | 33 |
| 5.1. Ndotja e ajrit .....                                                               | 34 |
| 5.2. Ndotja e ujit .....                                                                | 35 |
| 5.3. Ndotja e tokës .....                                                               | 36 |
| 5.4. Zhurma .....                                                                       | 37 |
| 5.5. Ndikimet në florë dhe faunë .....                                                  | 37 |
| 6.0. VLERËSIMI I RREZIKIMIT TË MJEDISIT NGA AKSIDENTET E MUNDSHME .....                 | 38 |
| 6.1.1 Analiza e trungut të ngjarjeve .....                                              | 40 |
| 6.1.2. Ngjarja në tërë rezervarin .....                                                 | 41 |
| 6.1.3. Aksidenti në pjesë të rezervarit (vrina në rezervar) .....                       | 41 |
| 6.2. Analiza e pasojave .....                                                           | 42 |
| 6.2.1. BLEVE .....                                                                      | 43 |
| 6.2.2. Zjarri në rezervar .....                                                         | 43 |
| 6.3. Vlerësimi i rrezikut .....                                                         | 43 |
| 6.3.1. Vlerësimi i gjasave të ndodhjes së aksidentit .....                              | 43 |
| 6.3.2. Vlerësimi i pasojave të mundshme .....                                           | 44 |
| 7.0. MASAT E MBROJTËS SË MJEDISIT .....                                                 | 45 |
| 7.1. Masat për mbrojtjen e ajrit .....                                                  | 45 |

|                                                                                |           |
|--------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| 7.2. Masat mbrojtëse të ujërave .....                                          | 46        |
| 7.3. Masat për mbrojtjen e tokës .....                                         | 48        |
| 7.4. Masat mbrojtëse në rezervar .....                                         | 50        |
| 7.5. Masat mbrojtëse në sistemin shpërndarës .....                             | 50        |
| 7.6. Rekomandimet tjera për evitimin e rrezikut dhe mbrojtje të mjedisit ..... | 51        |
| 8.0. MONITORIMI DHE RAPORTIMI .....                                            | 52        |
| 9.0 MARJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITET .....            | 52        |
| 10.0 Kontrolli i emisioneve pas përfundimit të aktivitetit .....               | 53        |
| 11.0. PËRFUNDIM .....                                                          | 54        |
| <b>12.0 LITERATURA .....</b>                                                   | <b>55</b> |
| Shtojcë .....                                                                  | 55        |

## 1. HYRJJE

Në kuadër të investimeve për ndërtimin e objektit afarist pompë e derivative me etazhet P+0 të kompanisë **“Kijeva Group BSV” Shpk**, me numer unik të biznesit 811151018, është paraparë edhe hartimi i raportit mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis sipas kërkesave të legjislacionit mjedisor të Kosovës, veçanërisht sipas Ligjit nr. 08/L-181. Ky raport do të përfshijë në vete analizat e realizuara të ndikimeve të mundshme në mjedisin rrethues, duke përfshirë edhe botën e gjallë lidhur me aktivitetin e pikës së deponimit dhe shitjes së karburanteve të lëngëta të naftës, restoration dhe marketin, në parcelat nr. **P-72310037-00131-1 dhe P-72310037-00130-3**, në zonën kadastrale Kijevë komuna e Malishevës.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis paraqet një dokument të nevojshëm dhe të domsodoshëm për paisjen e kompanisë me pëlqim mjedisor nga ana e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i cili poashtu është i nevojshëm për marrjen e lejës mjedisore dhe lëshimin në punë të pompës së derivateve me etazhet P+0.

Qëllimi i hartimit të raportit është evidentimi i të gjitha kushteve përreth në lokacionin ku bëhen planifikimi për investime dhe realizime të aktiviteve përkatëse, bazuar në faktin se në kohën moderne po bëhen intervenime të vazhdueshme në mjedisin natyror, duke ndikuar kështu në humbjen e balancës ekologjike natyrore. Bazuar në qëllimin paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky raport bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për t’u marrë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet eventuale negative të këtij aktiviteti. Ndaj është e nevojshme që shoqëria të ndërgjegjësohet për t’a mbajtur sa më pastër mjedisin ku jetojmë duke marrë masat e duhura për trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve të dëmshëm në atmosferë që gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme.

Raporti paraqet në mënyrë transparente ndikimin në mjedis të stacionit të karburanteve me objektet përcjellëse me të gjitha veprimtarit punuese (shërbim,

transport, deponim, trajtimi i materieve të rrezikshme etj), në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis për stacionin e karburanteve të kompanisë „**Kijeva Group BSV**” Sh.p.k, me seli në Kijevë, komuna e Malishevës, me pronar z. Besim Ukaj është hartuar, duke u bazuar në projektin ideor të ndërtimit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit ku është ndërtuar stacioni i karburanteve si dhe dokumenteve tjera teknik ekzistues.

Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-së të stacionit të karburanteve kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis gjerë në kufijtë e lejuar.

Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë, për fazën e ndërtimit, gjatë fazës së aktiviteteve të punës dhe pas përfundimit të aktivitetit të punës të stacionit të karburanteve në zonën kadastrale Kijevë komuna e Malishevës.

### **2. BAZA LIGJORE E PËRPILIMIT TË RAPORTIT TË VNM-së**

Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM-së) është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Ligji Nr. 08/L-181, i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM -së.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Ligji Nr. 08/L-181, ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti në mjedis gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve:

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative gjerë në kufijtë e lejuar.

### **2.1. Rregullativa Ligjore**

#### **a) Dokumentacioni normativ**

Me rastin e hartimit të raportit të VNM-së për stacionin e karburanteve janë marrë për bazë ligjet me të rëndësishme të aplikuara ku janë paraqitur më poshtë:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për VNM Nr. 08/L-181
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji nr. 08/L-112 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 02/L-26 për token bujqësore
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11
- Ligji për Kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për mbrojtjen e ajrit Nr. 03/L- 160
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga ndotja nr. 08/L-025
- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Ligjit Nr. 03/L-138, për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 02/L-89 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë

#### **Udhëzimit Administrative:**

- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.
- Udhëzimi administrative (Ligji Nr. 04/L-230) AME-Agjensioni për Menaxhimin e Emergjencave - MPB.
- Udhëzim administrativ mmph Nr. 04 /2018 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme.
- Udhëzim administrative Nr.05/2011 për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat për eliminimin e pasojave.
- Udhëzim administrativ (QRK) Nr.08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave.

### **b) Dokumentacioni teknik**

- Projekti ideor i ndërtimit të stacionit të karburanteve me objektet përcjellëse,
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit
- Çertifikatat mbi të drejtat e pronës
- Kopja e planit të ngastrave
- Plani i situacionit
- Pëlqimi nga AME
- Pëlqimi për kyqje në rrugë
- Leja ndërtimore

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshtënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar dhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse si që është direktiva e VNM-së.



### 2.2. Metodologjia e Punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për stacionin e karburanteve me objektet përcjellëse, bëhet në disa faza.

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet siç janë:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis.
- Popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- Karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin ku është planifikuar të ndërtohet stacioni i karburanteve,
- Klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- Kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,
- Bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar,

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve:

- Madhësia dhe lloji i ndotjes
- Karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- Gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- Vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse.

c) Analiza e rrezikimit të

- Njeriut
- Vlerave materiale
- Vlerave natyrore

d) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku është planifikuar të ndërtohet stacioni i karburanteve.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kvantifikimit dhe vlerësimin të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

### 3.0. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT


Për hartimin e një raporti të vlerësimit të ndikimit në mjedis bazë kryesore e tij janë karakteristikat themelore. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren.

Për tu definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

#### 3.1. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyç të hulumtimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të lokacionit ku është duke u ndërtuar stacioni i karburanteve, me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësit e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre. Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror siç janë toka, uji, ajri, relievi, flora dhe fauna. Secila nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit. Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme është paraqitur në figurën 1.

Në bazë të raporteve të paraqitura në këtë figurë është e qartë që faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristikat funksionale të të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të ndikimit në mjedis të stacionit të karburanteve të planifikuar për tu ndërtuar në hapësirën e lartcekur.



*Fig. 1. Raportet themelore ndërmjet faktorëve natyrorë dhe potencialeve ekologjike.*

### 3.2. Pozita gjeografike e lokacionit

Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ngërthen në vete karakteristikat themelore të gjendjes egzistuese, karakteristikat themelore të gjendjes së lokacionit së bashku me kushtet klimatike e demografinë të vendit. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren, përmes analizave vizuele dhe informatave të marra nga ana e vetë personave përgjegjës të kompanisë **“Kijeva Group BSV” Sh.p.k**, Kijevë komuna e Malishevë.

Lokacioni i Objekti afarist – Pikë karburanti me etazhitet P+0 të kompanisë **“Kijeva Group BSV” Sh.p.k**, ndodhet në rrugën Prishtinë – Pejë, në parcelat kadastrale me numër: **P-72310037-00131-1 dhe P-72310037-00130-3**, në zonën kadastrale Kijevë komuna e Malishevës, në vendin e quajtur të **Stapanica lugu i dhelpës**. Kompleksi shtrihet në zonë periferike të pjesës jug-përendimore të fshatit Kijevë dhe hapësira e tij kufizohet nga objektet afariste biznesore të cilat ofrojnë shërbime të ngjashme afariste.

Projekti i Pikës së karburantit të kompanisë „**Kijeva Group BSV**”- Shpk, i cili ndodhet në rrugën kryesore në drejtim Prishtinë - Pejë, në dalje të autostradës, përkatësisht afër rrethit të autostradës Prishtinë - Pejë, është rezultat i inkorporimit të nevojave në mes të konsumatorëve të lokaleve afariste, investitorëve dhe frekuentuesve të rrugëve lidhëse rreth lokacionit, aktualisht lloji i tokës është tokë Ndërtimore dhe u takon parcelave me numëra të ngastrës: **P-72310037-00131-1 dhe P-72310037-00130-3, në zonën kadastrale Kijevë komuna e Malishevës**, në vendin e quajtur të Stapanica lugu i dhelprës, parcelat janë në pronësi private të Besim Vesel Ukaj, pronar i kompanisë „**Kijeva Group BSV**”- Shpk, njëherit edhe aplikues i projektit për pëlqim mjedisor. Lokacioni ku është ndërtuar stacioni i karburanteve, është shëndrruar në zonë industriale (zona e Ndërtimit) dhe tragtare për shkak të pozitës gjeografike që ndodhet lokacioni, për arsye se afër lokacionit kalon rruga kryesore me katër korsi, rruga Prishtinë - Pejë e cila ka lidhje shumë të mira me të gjitha rrugët që bëjnë kyqjen dhe qkyqjen nga Regjioni i Dukagjinit, me pjesë tjera të Kosovës dhe Ballkanit me gjerë.

Përgjatë rrugës janë ndërtuar objekte afariste, tregëtare dhe industriale, siq janë disa stacione të karburanteve, restorante, markete, pastaj objekte me veprimtari si fabrika të gurit (përpunim i mermerit dhe graniti), autoservise dhe autopjesë, depot e materialit ndërtimor, objekte hoteliere e tregtare dhe lokale tjera asfarsite me veprimtar të ndryshme. Gjithashtu në një distancë jo ëshë shumë të largët ndodhën edhe disa shtëpi të banimit të fshatit Kijevë dhe Rixhevë, shtëpit e banimit janë kryesisht në distancë mbi 220 metra.

Në afërsi të drejtërdrejt të hapësirës ku është ndërtuar stacioni i karburanteve ndodhet objekte tjera afariste, si depo për autopjesë, zyre të administrates, depo për shtijen e pllakave të qeramikës, etj.


Lokacioni ku është ndërtuar stacioni i karburanteve në pjesën jugore kufizohet me objekte Afariste Prodhuese, nga ana lindore kufizohet me parcel ndërtuese, nga ana jugore kufizohet me parcelën të ndërtuar për afarizëm, nga ana veriore

kufizohet me rrugën kryesore Pejë – Prishtinë, gjithashtu edhe nga pjesa përendimore, kufizohet me objektet afariste tregtare dhe rrugën sekondare që lidhe fshatin Kijevë më zonën e Malishevës.

Në bazë të gjitha analizave është sajuar mundësia për vlerësimin global të gjendjes ekzistuese të mjedisit jetësor si dhe ndikimeve të mundshme negative gjatë punës së stacionit të karburanteve.

Këto vlerësime shërbejnë si bazë për kuantifikimin e ndikimeve të mundshme negative dhe për përcaktimin e masave të nevojshme mbrojtëse duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me një objekt specifik për pika karburanti të lëngët (naftë dhe benzene).

Për t'a pasur më të qartë vendodhjen e lokacionit, ky raport shoqërohet edhe me foton e mëposhtme si pamje satelitore.







Harta 1. Pamje e lokacionit ku është ndërtuar objekti afarist dhe stacioni i Karburanteve „Kijeva Group BSV”- Shpk




Foto 2. Situacioni i ngushtë i terrenit, Objekteve afariste dhe stacionit të Karburantëve



*Foto 3. Pamje nga lokacioni ku është duke u ndërtuar stacioni i Karburanteve „Kijeva Group BSV“- Shpk*



### 3.3. Pozita gjeografike e komunës së Malishevës

Komuna e Malishevës ka një sipërfaqe prej 306.3 km<sup>2</sup>, dhe shtrihet rreth koordinantav gjeografike: 42° 28 58 V dhe 20° 44 45 L. Ajo kufizohet: në veri me komunën e Klinës dhe të Drenasit, në lindje me komunën e Lipjanit dhe të Therandës, në jug me komunën e Therandës dhe të Rahovecit, dhe në perëndim me komunën e Rahovecit dhe të Klinës. Konfiguracioni i përshtatshëm i terrenit i mundëson komunës lidhje të mira të komunikacionit me të gjithë vendin. Me shumicën e qyteteve kryesore të Kosovës lidhet brenda një distance prej rreth 40-55 km - Gjakovë 40 km, Prizren 44 km, Prishtinë 49 km, Pejë 52 km, Ferizaj 56 km. Distancat më të mëdha janë me Mitrovicën-75 km, si dhe me Gjilanin - 80 km. Sa i përket lidhjeve ndërkombëtare, kalimi i autostradës Durrës-Merdarë përmes territorit të komunës e vë Malishevën në pozitë të volitshme. Kjo autostradë mundëson lidhje të lehtë dhe të shpejtë me Shqipërinë dhe portin e Durrësit, ndërsa planet për vazhdimin e mëtutjeshëm të kësaj autostrade, si dhe ndërtimi i autostradës se re për Han të Elezit do të mundësojnë lidhje cilësore me shtetet dhe korridoret rajonale të transportit. Pozita e komunës së Malishevës ofron përparësi edhe sa i përket vlerës dhe burimeve natyrore. Hapësira komunale e cila kufizohet me terrenet kodrinore në pjesën lindore (në kufi me Drenasin, Lipjanin dhe Suharekën) dhe në Jug-perëndim (që (në kufi me Rahovecin), si dhe shtrirja e sipërfaqeve të rrafshëta në qendër, ofrojnë një larmi të përmbajtjeve dhe potencialeve bujqësore, mjedisore dhe biodiversitetit.

Lokacioni në studim gjendet në zonën kadastrale Kijevë në anën e majtë të rrugës Nacionale Prishtinë – Pejë. Lokacioni ku është i ndërtuar stacioni i karburanteve është zonë e rrafshët, por gjithsesi që investitori para se të filloj ndërtimin e objektit ka ndërmarr masa për largimin e dheut si dhe përshtatjen e parcellës për qasje të lehtë në rrugën kryesore. Parcella në të cilën ndodhet objekti afarist stacioni i karburanteve është zonë RURALE.






*Fig.4. Pozita gjeografike e komunës së Malishevës*

### **3.4. Topografia**

Territori i komunës së Malishevës karakterizohet kryesisht me terren kodrinor-malor, si dhe me pjesë fushore përgjatë rrjedhave ujore. Përshkruhet nga pellgu i lumit Mirusha me tokë të rrafshët dhe pjellore në të dy brigjet e saja. Ky pellg është i rrethuar me Masivin Malor të Drenicës në lartësinë mbidetare deri në 1057 m (Maja e Kasmaqit), Majën e Koznikut në lartësinë mbidetare deri në 1006 m etj (shih Harten - Hipsometria).

Format më të rëndësishme të relievit janë masivi malor, luginat e lumenjve dhe ultësira e Llapushës. Kjo ultësirë është krijuar me dy morfologji të përgjithshme, malet e Drenicës në lindje dhe lugina e Mirushës në qendër (500-650m) me shpate të ngushta posaçërisht në anën perëndimore, ku bie në një pjerrësi prej 45° tek ultësira e Llapushës. Si elemente të veçanta në territorin komunal janë

shpellat. Shpella më e njohur dhe më e rëndësishme është “Shpella e Flladit”, në Panorc, me gjatësi të kanaleve prej 945 m (deri më tani e zbuluar), pastaj disa shpella tjera të rëndësishme sekondare në Kanjonin e lumit Mirusha”, në fshatin Bardhë-Guncat etj.



Harta 4 Hipsometria

### 3.5. Klima

Klimë dominuese është ajo e mesme kontinentale dominon me elemente të ndryshme mesdhetare, e cila karakterizohet me dimër të ftohtë dhe të gjatë (në fshatrat malore); verë të ngrohtë (në fshatrat më të ulëta). Temperatura mesatare është 24.6° në verë, si dhe -10° C në dimër. Sasia mesatare e reshjeve është afër 755,5 mm<sup>3</sup>. Në viset e ulta për shkak të ndikimit të klimës mesdhetare dhe verës shumë të nxehta të korrurat janë nder të parat në Evropën juglindore prandaj ekzistojnë përparsit e pakrahasueshme për kulturat bujqësore: Grurit, misrit, Luledjellit, hardhia e rrushit, pemët dhe perimet.

Sa i përket temperaturave dhe reshjeve, Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen përafërsisht me klimë të njëjtë.

Në përgjithësi mund të thuhet se në territorin e Kosovës, për shkak të ndikimit të faktorëve orografik, me kurorat malore të kufizuara, ka prani të veçorive specifike mikroklimatikë. Këta përbërës natyror kanë kushtëzuar që kjo lami është karakteristikë sipas asaj së gjatë pranverës dhe vjeshtës është kohë e ndryshueshme, kurse vjeshta është më e nxehtë se pranvera. Kushtet klimatike gjatë stinës së verës është mjaft stabile, derisa gatë stinës së dimri ka ndikime të aktiviteteve mesdhetarë.

### 3.6. Hidrografia

Lumi kryesor që kalon nëpër komunën e Malishevës është Mirusha, i cili i takon pellgut të Drinit të Bardhë. Mirusha buron nga malet e Bllacës (masivi malor i Carralevës), ndërsa burimi përbëhet nga dy degë (përrenj): përroi që rrjedh nga Nguncati dhe përroi që rrjedh nga Bllaca. Të dy këtë përrenj bashkohen në hyrje të fshatit Bellanicë për të krijuar lumin Mirusha. Në pjesën e poshtme të lumit Mirusha, në një gjatësi 2 km, është krijuar një grykë me 16 liqene lumore të madhësive të ndryshme, të lidhura me njëri-tjetrin me një ujëvara spektakulare me gjatësi prej 21 m (i dyti nga madhësia në Kosovë pas asaj në Radavc-Drini i Bardhë). Duke pasur parasysh vlerat mjedisore që Mirusha përmban në rrjedhën e saj dhe hapësirat përreth, zona rreth saj është shpallur Monument Natyror me Rëndësi të Veçantë.

Malisheva është e njohur edhe për burimin e ujit termal, i cili gjendet në fshatin Banjë, në anën e djathtë në lumit Mirusha. Në afërsi të këtij burimi është ndërtuar edhe pishina e hapur publike. Burime tjera të rëndësishme ujore në komunë janë: dy burime në fshatrat e Gurbardhit, burimet në fshatin Javiq dhe Panorc, rrjedha Belak në fshatin Maxharrë dhe burime të tjera ende të pa-evidentuara në malet e Gurbardhit.

### 3.7 Rrjeti ekologjik

Ndërtimi gjeologjik, peizazhi dhe kushtet klimatike kanë ndikuar që në një hapësirë relativisht të vogël të rezervuarit të lumit Mirusha të shfaqen

karakteristika të ndryshme të shtresave bimore. Sa i përket florës, drunjtë që rriten në këtë territor janë ahu, lisi, thana dhe në rrethinat e Mirushës rriten shelgjet. Nga barishtet rritet lulëkuqja (peonia decore), si dhe bimët mjekësore si bar-veshi, bar-pezmi, etj. Fauna në malet e Berishës karakterizohet me kafshë të egra si macja e egër, shqiponja, dallëndyshja, lejleku, bilbili, etj. Duke e pasur parasysh shtrirjen e sipërfaqeve pyjore në pjesët lindore dhe perëndimore kodrinore të territorit komunal, të pasura me një shumëllojshmëri të botës bimore dhe shtazore, si dhe korridoret përgjatë lumenjve që shtrihen përgjatë territorit komunal duke i lidhur këto tërësi pyjore, mund të thuhet se Komuna e Malishevës shquhet me një rrjet ekologjik i cili është i shpërndarë përgjatë tërë territorit të saj. Ky rrjet ofron potenciale hapësinore, mjedisore, si dhe të qarkullimit, andaj ato duhet të mbrohen dhe trajtohen në mënyrë qëndrueshme në të ardhmen.

### 3.8. Popullsia

Njërën nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqet popullata dhe demografia e saj. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorë që jetojnë në hapësirën e analizuar.

Numri i popullsisë sipas vlerësimeve, aktualisht në Komunën e Malishevës jetojnë 58341 banorë, që përbëjnë rreth 3% të banorëve të Kosovës. Prej numrit të gjithëmbarshtëm të banorëve në komunë, 3629 (rreth 6%) jetojnë në zonën urbane, që është dukshëm më e ulët se mesatarja e Kosovës prej 38%. Përveç numrit të banorëve rezident, vlerësohet se janë edhe rreth 15.000 persona nga Malisheva të cilët jetojnë jashtë vendit. Dendësia e popullsisë është 190.41 banorë për km<sup>2</sup>, që është pothuaj se e njëjtë me nivelin e Kosovës - 163.22 banorë për km<sup>2</sup>.

Prezantimi i të dhënave statistikore për vitet e mëparshme është bërë në bazë të regjistrimit të vitit 1948/'71, ndërsa për vitet 1981/'91 të dhënat janë mbledhur

nga statistikat në Beograd. Nuk kishte asnjë regjistrim të duhur zyrtar në vitin 2001, por Agjencia e Statistikave të Kosovës ka kryer vlerësimin e popullsisë. Regjistrimi i mëparshëm dhe vlerësimi i popullsisë i kryer nga autoritetet e Kosovës përfshin numrin e përgjithshëm të popullsisë, ndërsa të dhënat e regjistrimit të vitit 2011 përfshijnë vetëm popullsinë rezidente. Duke marrë këtë konsideratë mungesën e konsistencës, është e vështirë të jepet një vlerësim i saktë për numrin e rritjes së popullsisë gjatë viteve.

Në afërsi të drejtëprdrejt ngastrës ku është planifikuar të ndërtohet stacioni i karburanteve nuk ndodhen objekte të banimit, objektet e banimit më të afërta ndodhen në distancë mbi 220 metra nga stacioni i karburanteve, kështu që në pikëpamje mjedisore, stacioni i karburanteve nuk do të ketë ndonjë ndikim relevant në popullatë, përpos që do të kenë vetëm dobi sepse një numër i popullatës do të punësohen në stacionin e karburanteve për kryerjen e aktiviteteve të ndertimit dhe aktiviteteve shërbyese pas fazës së ndërtimit.

### **3.9. Infrastruktura ekzistuese**

Shtirja e rrjetit rrugor në territorin e Malishevës si dhe përmbajtja e të gjitha niveleve të hierarkisë rrugore kombëtare dhe komunale, mundësojnë lidhje të mira brenda Kosovës si dhe në nivel ndërkombëtar. Duke qenë një udhëkryq lokal regjional, rruga nacionale dhe ato regjionale përballojnë trafik të ngarkuar apo mesatarisht të ngarkuar, që vërehet sidomos në qytetin e Malishevës, ku kryqëzohen rrugët regjionale. Intervenimet e viteve të fundit kanë bërë që cilësia e rrugëve që lidhin komunën dhe vendbanimet të jetë kryesisht e mirë, ndërsa ende ka nevojë për intervenime në krijimin e kushteve më të mira të sigurisë dhe për lëvizjen e këmbësorëve.

#### **Rrugët e nivelit kombëtar - Autostrada Durrës-Merdarë**

Shtrihet në pjesën lindore të komunës, rrëzë terreneve kodrinore. Gjatësia e segmentit të Malishevës është 12.6 km. Përmes kësaj rruge Malisheva bëhet pjesë e korridoreve me rëndësi ndërshtetërore regjionale. Ekzistojnë dy nyje përmes të



cilave Malisheva lidhet me këtë autostradë - në veri, afër fshatit Arllat dhe në jug afër Banjës. Në nivel ndërkombëtar kjo autostradë mundëson lidhje të shpejtë me korridorin VIII në jug dhe me portin e Durrësit, si dhe me korridorin X në veri. Ndërtimi i planifikuar i autostradës së re që lidhë me vendkalimin kufitar në Han të Elezit për në Maqedoni do ti përforcojë edhe më tutje këto lidhje. Në nivel të Kosovës, autostrada mundëson lidhje të shpejtë me Prishtinën dhe Prizrenin. -

### **Rruga nacionale Prishtinë - Pejë (N9)**

Shtrihet në pjesën veriore të komunës, në mesh fshatrave Balincë dhe Kijevë. Gjatësia e segmentit të Malishevës është 12 km. Përmes kësaj rruge mundësohet lidhja me Pejën dhe më tutje me Malin e Zi, si dhe lidhja e shpejtë me autostradë. Kryqëzime me rëndësi në këtë rrugë janë kryqëzimi i Kijevës, ku lidhet me rrugën regjionale për Malishevë, si dhe nyja në Gjurgjicë (jashtë territorit komunal) përmes së cilës lidhet me autostradë. Duke e pasur parasysh rëndësinë që e ka, kjo rrugë është relativisht e ngarkuar me trafik. Gjendja fizike e rrugës vlerësohet si e mirë. Profili përbëhet prej dy shiritave me nga 3.5 metra, ndërsa trotuari ekziston vetëm në disa segmente. Zhvillimi i vendbanimeve përgjatë trasesë rrugore përbën një çështje sa i përket sigurisë në trafik.

Në afërsi të lokacionit ku është duke u ndërtuar objekti afarist stacioni i karburanteve dhe infrastruktura percjellese, afër lokacionit kalon rruga kryesore Prishtinë - Pejë, largësia nga kjo rrugë është në distance mbi 10 metra, e cila mundëson kyçjen me gjithë rrjetin rrugor të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu në këtë lokacion është funksionale infrastruktura ujore (e ujësjellësit dhe kanalizimit), dhe infrastruktura energjetike, furnizimi me energji elektrike i stacionit të karburantit me objektet percjellëse bëhet përmes rrjetit elektrik dhe trafos private, që do të e ndërton pronari i kompanisë.

### **3.10. Trashëgimia natyrore**

#### **Monumentet natyrore**

Komuna e Malishevës shquhet me trashëgimi të pasur natyrore. Deri më tani janë të evidentuara 22 monumente të trashëgimisë natyrore, të shpërndara përgjatë gjithë territorit komunal.

### **Monumentet Natyrore Hidrografike**

Si Monumente Natyrore Hidrografike janë të kategorizuara tri monumente: Ujëvarat e Mirushës, Burimi Termal në Banjë dhe Burimi në Gurbardh.

**Ujëvarat e Mirushës** - Ujëvarat e Mirushës janë shpallur Park Regjional i Natyrës në vitin 1982/83 nga Komuna e Klinës dhe Rahovecit, tanimë e trashëguar nga Komuna e Malishevës, me sipërfaqe prej 555.80.70 ha. Ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2012 nxjerr vendim për shpalljen e Ujëvarave të Mirushës Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë me sipërfaqe të përgjithshme prej 598.4 ha, dhe i takon kategorisë III. Në mars të vitit 2014 Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Planin Hapësinorë për zonën e mbrojtur “Ujëvarat e Mirushës”, të hartuar nga Instituti për Planifikim Hapësinor. Kanjoni i Mirushës është një ndër zonat më interesante të natyrës së Kosovës, e cila përfshinë pjesën e poshtme të rrjedhës së Mirushës. Në këtë pjesë të kanjonit janë 16 ujëvara me liqene që e përbëjnë pjesën më atraktive të kanjonit. Në kuadër të territorit të monumentit gjendet Kisha e Eremitëve - fshati Ularicë, e cila mbrohet me Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.

**Burimi Termal në Banjë** klasifikohet si Monument Natyror Hidrografik i Kategorisë III. Burimi i ujit termal ka kapacitet 250-300 l/sec, ndërsa mbi këtë burim të ujit është ngritur pishina me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup>, e cila çdo sezon vere është në shfrytëzim për freskim gara të notit. Uji i kësaj pishine ofron edhe mundësi shërimi nga një numër i caktuar i sëmundjeve të lëkurës. Temperatura konstante e ujit gjatë tërë vitit është 22°C. Ky vend vlerësohet me potencial për turizëm, rekreacion, sport dhe rehabilitim.

Komuna e Malishevës karakterizohet edhe me prezencën e shpellave në Panorc, në Kanjonin e lumit “Mirusha”, në fshatin Bardhë-Guncat etj. Shpella më e njohur dhe më e rëndësishme është “Shpella e Flladit”, në Panorc, me gjatësi të

kanaleve prej 945 m (deri më tani e zbuluar). Klasifikohet si Monument Speleolgjik i Kategorisë III; shpella e Temeqinës; shpella e Bozhurit në Damenek; shpella e Lladroviqit;

**Monumentet tjera natyrore** - Përveç monumenteve të përmendura më sipër, në kuadër të territorit komunal janë të listuara edhe 19 monumente të natyrës. Në kuadër të tyre përfshihen Malet e Berishës, Liqeni Artificial në Mirushë, rrjedha e lumit Mirusha, me rëndësi hidrologjike dhe peizazhore 4 ; burimi në fshatin Burim, 4 shpella (Temeqinë, Ularicë, Bardh, Drenoc), 10 drunj karakteristik: trungu i Qarrit në Lladrovç, Carravanë, Drenoc, Bubël, Bellanicë 5 trungjet bungutës me karakter botanik në fshatin Llozicë, Guriq; trungu i frashrit gjethengushtë në Javiq dhe Zabeli dhe Vrella në Vërmicë. Prej këtyre monumenteve, Malet e Berishës klasifikohen në kategorinë III, për shkak të vlerave mjedisore që i ka.

### 3.10. Biodiversiteti

Në Komunën e Malishevës ekziston një larmi e bimësisë e cila gjendet edhe në Pendëkaposhi i Mayerit, Petriku i Grojterit, të cilat gjendet në zonën e Mirushës dhe është në listen e Bimëve endemike të florës vaskulare, karakteristike për Kosovën (Burimi: Flora vaskulare Endemike e Kosovës); *Gipsofilë* (emri shkencor *gypsophila spergulfolia Griseb*), e cila është bime e rrallë; *Lule Bozhuri Bozhuri dekorativ/Paeonia decera Anders*, të cilat gjenden në territorin e Malishevës.

### 3.11. Shfrytëzimi i tokës

Komuna e Malishevës ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 30,642.00 Ha, të ndarë në 39 zona kadastrale. Pjesa me e madhe e territorit komunal përfshihet nga tokat bujqësore 52%, të pasuara me tokat pyjore 38%. Sipërfaqet ujorë përfshijnë 0.2% të territorit. Sa i përket sipërfaqeve të ndërtuara, vendbanimet përfshijnë 8% të territorit, ndërsa infrastruktura e transportit përfshinë 2%. Viteve të fundit ka pasur një rritje të ndjeshme në ndërtim, e cila ka shkaktuar presione mbi sipërfaqet e tokës. Informatat e mbledhura mbi shfrytëzimin e tokës ofrojnë një bazë për menaxhimin e zhvillimit të qëndrueshëm të

sipërfaqeve të tokës, duke siguruar të dhëna për politikat zhvillimore në të gjithë sektorët. Rrjeti rrugor dhe hapësirat përcjellëse përfshijnë 499.9 ha të territorit komunal, përkatësisht 1.6% të saj. Prej kësaj sipërfaqeje, pjesën më të madhe e përfshinë brezi i autostradës Durrës - Merdarë me 152.2 ha, të shtrira përgjatë 12.6 km në kuadër të territorit komunal. Brezi i rrugës nacionale Prishtinë - Pejë (N9) përfshinë 27.6 ha, brezi i rrugës regjionale Malishevë-Rahovec (110) përfshinë 30.7 ha, ndërsa brezi i rrugës regjionale Malishevë - Suharekë 38.6 ha. Sipërfaqet rrugore të nivelit kombëtar janë të asfaltuara dhe ofrojnë kushte të mira të qarkullimit motorik. Në kuadër të rrjetit në nivel komunal, rrugët lokale përfshijnë gjithsej 121.9 ha të shtrira në një gjatësi të gjithëmbarshme prej 155.5 km. Rrugët e vendbanimeve përfshijnë gjithsej 128.2ha, të shtrira një gjatësi të gjithëmbarshme prej 192.2 km. Rrugët lokale janë përgjithësisht të asfaltuara dhe në gjendje relativisht të mirë për qarkullimin motorik. Rrugët e vendbanimeve janë pothuajse të gjitha të asfaltuara, përveç në disa raste të pakta në kuadër të lagjeve.

### **3.12. Flora dhe Fauna**

Ndikimi i shërbimit të kompleksit të stacionit të karburanteve në domenin e florës dhe faunës paraqet dukuri që kërkon shqyrtim të kujdesshëm, në kuptim të evidencimit të pasojave të ndryshme të mundshme negative dhe zvogëlimit të tyre brenda kufijve të pranueshëm. Ajo që dallon florën dhe faunën e këtij regjioni janë ndryshimet intensive si pasojë e veprimtarisë së njeriut.

Ngastrat ku është duke u ndërtuar stacioni i karburanteve, më herët ka qenë e mbjellur me bimësi si kultura bujqësore sezonale, kurse tani nuk ekziston bimësi me të mbjellura me të lashta periodike bujqësore, sepse në të janë të ndërtuara objekte tjera afariste. Mirëpo në bazë të shqyrtimeve vizuale në rrethin të zonës më të largët ku realizohet projekti kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore, kultura periodike bujqësore si dhe të gjitha pemët frutore të grupit faror dhe atyre bërthamore.

Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për Mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë lokacion kemi të bëjmë me hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi. Përveç, disa objekteve të kultit religjioz.

Duke marrë parasysh karakteristikat e gjendjes ekzistuese mund të konstatohet se në lokacionin e këtij regjioni nuk ka potenciale të shprehura të vegjetacionit të cilat mundë të rrezikohen me funksionimin e stacionit të karburanteve.

Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit, e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga banorët, në këtë zonë përpos kafshve dhe shpezve shtëpiake në zonën jashtë vendbanimeve jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, ujku, derri i egër etj. Prej brejtësve jetojnë- mijtë, prej zvarranikëve- gjarpri i zakonshëm, breshkat e tokës zhapini i gjelbër etj, ndërsa prej shpezëve janë karakteristike, bilbilat, thëllënëza e fushës, sorrat, shqiponja, etj.

### **3.13. Karakteristikat sizmike**

Sizmikja mikro - regjionale e këtij lokacioni dallohet me mundësi të dridhjeve të tokës të intensitetit prej rreth 7 shkallë të Merkalit.

Sipas hartave sizmike të regjionit, hapësira e gjerë e hulumtuar nuk i përket një intensiteti të njëjtë të dridhjeve sepse varet nga karakteristikat gjeologjike të tokës, thellësisë së ujërave nëntokësore etj.

### **3.14. Efektet vizuale**

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin kompleks i stacionit të karburanteve - mjedisi.

Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive. Sipas projektit të planifikuar ndërtimi

i kompleksit të objektit afarist dhe stacionit të karburanteve nuk ka ndonjë ndikim negativ në prishjen e peizazhit në lokacionin e analizuar, sepse siç e cekëm më lart planifikohet të ndërtohet në zonën ku janë të ndërtuara objektet tjera afariste dhe biznesore, prandaj stacioni i karburanteve nuk ndikon në shikuesin, sepse syri i njeriut është mësuar me këte gjendje të mjedisit.

### **3.15. Ajri**

Në lokacionin në fjalë deri tani nuk janë bërë matje mbi shkallën e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës në mënyrë që të bëhet një vlerësim sa më preciz i gjendjes mjedisore për lokacionin ku është duke u ndërtuar stacioni i karburanteve nga kompania „Kijeva Group BSV” Shpk në zonën kadastrale Kijevë komuna Malishevës.

Nga vetë konfiguracioni i terenit, dhe për shkak të objekteve afariste dhe biznesore që janë ndërtuar dhe janë duke u ndërtuar në këte lokalitet të cilat ndikojnë mjaft në ndotjen e ajrit, mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit në këtë region është në nivel mesatar.

Gjithashtu frekvenca e madhe e automjeteve në rrugën kryesore, ndikojnë në ndotjen e ajrit, gjithashtu në ndotjen e ajrit ndikojnë dhe pajimet agro teknike të cilat nevojiten për kryerjen e punëve bujqësore.

## **4. PROCESI TEKNOLOGJIK**

### **4.1. Përshkrimi i pajimeve dhe objekteve ndërtimore**

Kompleksi i objektit afarist stacionit të karburanteve të kompanisë „Kijeva Group BSV” Shpk në zonën kadastrale Kijevë komuna e Malishevës, në bazë të projektit ideor të ndërtimit, do të përbëhet prej këtyre pajimeve dhe objekteve të cilat si tërësi nevojiten për realizimin e veprimtarive në stacionin e karburanteve, dhe mini-marketit si dhe mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet e mundshme negative që shkaktohen nga stacioni i karburanteve.



Në vijim po i shënojmë pajimet dhe objektet që do të përbëjnë kompleksin e stacionit të karburanteve:

- Objekti i cili përmban hapësirën për administratës, hapësirën për shitjen e derivative, vajrave dhe lubrifikanteve, hapësirën për market.
- Terrasa
- Platoja e pompës
- Hapsirat e parkingjeve
- Hapësira ku janë vendosur rezervarët e naftës dhe benzinës
- Aparatet për toçitje të naftës dhe benzinës
- Streha
- Hapsira për gjenerator
- Seperator për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura
- Gropa septike për ujërat e zeza
- Bunari filtrues
- Grumbulluesit e ujit
- Oazat gjelbëruese.
- Rrethoja e lokacionit.
- Shtyllat e reklamës.

#### **4.2. Objekti i administratës**

Në aspektin funksional objekti është i ndarë në 3 seksione:

Seksioni 1- Përmbanë hapsirën për vendosjen e tre (3) dispancereve për furnizim me karburante dhe akomodimin e automjeteve në të njëjten kohë.

Sipërfaqja e shpites së ndërtesës kryesore pa seksionin 1 (pa hapsirën e dispaqereve). Në kuader të sajë përfshihen seksioni 2 dhe seksioni 3. Dyshemeja do të punohet nga pllakat qeramike dhe ngjitës, mbi shtresën e estrishit me trashësi 4-5 cm.

Ne objekt do të vendosen pikat e sanitarisë dhe Hidranti. Pikat e sanitarisë do të punohen krejt sipas rregulloreve dhe standardeve të kohës.

**Seksioni 2** - Përmban hapsiren me funksione afariste. Në kuader të sajë përfshihen: Marketi me hapsirat ndihmese percjellese depo dhe sanitarite.

**Seksioni 3** - Përmban hapsiren per administrate. Ky seksion permban 3 zyre dhe 3 sanitari.

Mbulesa (streha) e stacionit për shitjen e karburanteve është punuar nga konstruksioni i kapriates metalike, trau kryesor duhet ndërtuar nga shufrat metalike T,2L. Mbi kapriate duhet të vendosën brinaket te profilit I-140 (metalike) dhe mbi te llamarina e plastifikuar.

Për arsye estetike streha ne anët e jashtme të mbulesës duhet punuar me një panel nga llamarina e plastifikuar.

Ana e poshtme e mbulesës duhet punuar nga llamperia metalike, në bazë të specifikacionit të përshkruar në projektin ideor për ndërtimin e stacionit të karburanteve.

### **4.3. Platoja e kompleksit**

Platoja e kompleksit të stacionit të karburanteve „Kijeva Group BSV” shpk duhet rregulluar ashtu që pjerrtësia të jetë e përshtatshme për percjelljen e ujërave sipërfaqësore, të tërë pjesës për rreth objektit administrativ, marketit dhe për rreth objektit për shitjen e karburanteve i tëri duhet betonuar. Organizimi për funksionimin e këtij stacioni të karburanteve është i destinuar për funksionimin e qarkullimit ne rrugën magjistrale dhe regjionale që lidh Prishtinën me Pejën dhe qytete tjera, hyrja dhe dalja e automjeteve në kompleksin e stacionit të karburanteve do të bëhet pa pengesa sepse hapësira për hyrje në stacion të karburanteve dhe dalje është e mjaftueshme dhe dukshmëria është e lartë.

### **4.4. Rezervarët e lëndëve djegëse të lëngëta (naftë dhe benzinë)**

Në bazë të projektit kryesor për ndërtimin e stacionit të karburanteve do të vendosen tre rezervar për depozitimin e naftës dhe benzinës, në bazë të matjeve dhe caktimit të tabelave për matjen dhe percjelljen e sasisë së derivateve në rezervar është caktuar kapaciteti i rezervarëve dhe atë:

- Kapaciteti i rezervuareve  $R_1$ - 13600 litra,  $R_2$ - 16000 litra ,  $R_3$ - 40000 litra, **Naftë dhe Benzin,**
- Kapaciteti i përgjithshëm i rezervarëve për karburant do të jetë  $V_p = 70\,000$  **litra.**

Rezervarët janë cilindrik të ndërtuar prej çelikut me mure të dyfishtë sipas standardeve të caktuara për rezervarët për deponimin e lëndëve djegëse të lëngtë dhe të vendosur nën tokë në pozitë horizontale, në hapësirën e betonuar dhe të rrethuar me mure betoni, të mbështetur në tri mbajtëset (shalat) nga betoni dhe të shtrënguara me nga dy shirita metalik anti korroziv për secilën mbajtëse, me qëllim të përforcimit për të mos lëviz nga presionet e ndryshme nëntokësore. Mbrojtja nga korrozioni do të bëhet për mes sistemit të katodës dhe me ngjyrë konform standardeve.

Mbushja dhe zbrazja e rezervarëve do bëhet nëpër mes sistemit të gypave special të cilët do të vendosen në kanal prej betoni për mbrojtjen e tyre nga dëmtimet eventuale.




Fig 5. Rezervuaret për Naftë dhe Benzinë

#### 4.6. Karakteristikat kryesore të procesit teknologjik në stacionin e karburanteve

Procesi teknologjik në stacionin e karburanteve përfshin këto operacione të veprimit që janë të ndërlidhura në mesë vete.

- Sistemi për zbrazje
- Sistemi për deponimin e karburanteve
- Sistemi për dhënien (toçitjen) e karburanteve

Sistemi për zbrazje të karburanteve të lëngët bëhet nga autocisternat me ramje të lirë (apo me anë të pompës) përmes sistemit të gypave prej gome, të cilët përmes një kyçe speciale lidhen me gypin në rezervuar.

Matja e sasisë së deponuar në rezervuar do të matet drejtpërdrejt nga instrumentet matëse të vendosur në autocisternë ose përmes levës së bazhdaruar dhe tabelave të veçanta për çdo rezervuar.

Sistemi i gypave dhe instrumenteve matëse kontrollohen para zbrazjes, në mënyrë që të eliminohen dukuritë e situatave aksidentale.

Sistemi për deponim të karburanteve do të përbëhet nga tre (3) rezervar të gjithë janë të ndarë në mes vete, ndersa 2 nuk janë të ndare për depozitimin e naftës dhe 1 për benzinë, me vëllim total  $V_p = 70\,000$  litra. Sistemi për dhënien apo toçitjen e karburanteve të lëngët do të përbëhet prej tre ishuj me pesë (5) pajisje automatike me nga dy (2) gypa për toçitje për karburant të lëngët, gjithsejtë tetë (8) gypa për toçitje për karburant të lëngët. Mbushja dhe zbrazja e rezervarëve do të bëhet nëpër mes sistemit të gypave special të cilët do të vendosen në kanal prej betoni për mbrojtjen e tyre nga dëmtimet eventuale. Sistemi për dhënie të karburanteve (automatët) do të jenë të mbrojtur nga rreziku eventual.

#### **4.7. Komponentët hyrëse në procesin teknologjik**

Komponentët hyrëse nga aktivitetet që zhvillohen në stacionin e karburanteve janë:

- Karburantet djegëse të lëngëta (naftë dhe benzinë).
- Energjia elektrike.
- Uji

Karburantet djegëse të lëngëta benzina dhe nafta shërbejnë për furnizimin e automjeteve, për nevoja në amvisni në industri etj. Sasia e përgjithshme e karburanteve të lëngëta në stacionin e karburanteve do të jetë  $V = 70\,000$  litra.

Energjia elektrike shërben për ndriçim dhe funksionim të pajisjeve si dhe për nxehje. Furnizimi me energji elektrike do të bëhet nga rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike varësisht nga kapaciteti i qytetit ose do të paiset me trafo personale.

Uji shfrytëzohet për qëllime sanitare, për larjen e platosë së stacionit të karburanteve dhe për furnizim të pajisjeve kundër zjarrit.

Nevojat e ujit për sanitari varet nga numri i punëtorëve p.sh për një punëtor nevojiten 25 lit. ujë/ditë.

Furnizimi me ujë në kompleksin e stacionit të karburanteve „**Kijeva Group BSV**” **Sh.p.k**, i cili shfrytëzohet për qëllime sanitare do të bëhet nga sistemi i ujësjellësit, kurse furnizimi me ujë i cili shfrytëzohet për qëllime për larje të platosë si dhe ujitjen e sipërfaqeve të gjelbëruara, dhe për furnizim të pajisjeve kundër zjarrit do të bëhet nga pusi që duhet nxjerrur me shpim të thellë nga pronari i stacionit të karburanteve.

#### **4.8. Komponentët dalëse në procesin teknologjik**

Komponentët dalëse nga aktivitetet që zhvillohen në stacionin e karburanteve janë:

- Karburantet djegëse te lëngëta (naftë dhe benzinë)
- Ujërat e ndotura.
- Avujt e hidrokarbureve dhe gazrat shkarkuese nga automjetet.
- Zhurma.
- Mbeturinat e ngurta.

### **5. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis**

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit si dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të cilat janë si pasojë e proceseve (veprimeve) që kryhen në stacionin e karburanteve tregojnë se deri te kuantifikimi i të dhënave mund të vihet sipas një analizë gjithëpërfshirëse.

Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta që të bëhet edhe kuantifikimi i tyre. Ndikimet negative në mjedis mund lajmërohen në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit, prandaj të gjitha ndikimet e mundshme negative në mjedis i klasifikojmë në tri perioda themelore dhe atë: Vlerësimi dhe përshkrimi i



ndikimeve negative në mjedis duhet të bëhet për fazën ndërtimit të stacionit të karburanteve, gjatë punës kontinuele të stacionit të karburanteve vie deri te rritja e emisionit të materieve ndotëse nga puna e automjeteve, avullimi i karburantit benzinë, derdhjet dhe avullimi i karburanteve të lëngët, krijohet zhurmë nga motorët e automjeteve dhe funksionimi i automatëve për dhënie të karburanteve, në mënyrë indirekte mund të vie deri te ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe sipërfaqeve të dheut afër stacionit të karburanteve. Entitetet e cënueshme që potencialisht rrezikohen janë të punësuarit në stacion dhe shfrytëzuesit e shërbimeve-konsumatorët.

Gjithashtu duhet parapa ndikimet e mundshme negative në mjedis pas përfundimit të aktivitetit punuese në stacionin e karburanteve.

### 5.1. Ndotja e ajrit

Gjatë fazës së ndërtimit të objektit stacionit të karburanteve, nuk kemi ndotje të theksuar të ajrit. Ndotja e ajrit ndodhë nga makinat ngarkuese dhe automjetet transportuese, që nevojiten për gërmimin e bazamentit dhe transportimin e materialit ndërtimor, ndotja nga pluhurat që lirohen nga sipërfaqet punuese, gjatë realizimit të fazës së ndërtimit të stacionit të karburanteve.

Gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve nga qarkullimet e automjeteve vie deri te rritja e ndotjes së ajrit nga emisioni i gazrave nga automjetet dhe nga avullimi i karburanteve.

Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentracione të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NO<sub>x</sub>, HxCy, SO<sub>2</sub> dhe Pb.

Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike – meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të automjeteve në komunikacion në lokacionin e stacionit të karburanteve. Ndotje të ajrit mund të ndodh nga gazrat të cilët lirohen nga lëndët djegëse që nevojiten për përgatitjen e ushqimit, dhe ngrohjen e hapësirës së adimistratës dhe minimarketit gjatë stinës së dimrit,

e cila ndotje është minimale, ndotja e ajrit ndodh nga avujt që lirohen nga vaji në hapësirat e kuzhinës, që nevojitet për përgatitjen e llojeve të ushqimit.

Pra, themi që në mënyrë të paevitushme, në kohën e mbushjeve të serbatorëve të makinës, ka çlirime avujsh në rastin e benzinave, çlirime avujsh hidrokarburesh që përmbajnë kryesisht benzen, ksilen, toluene, etil benzeni, etj. Që të gjithë janë shumë fluror që me rritjen e temperaturës së ambientit, kanë një shkallë avullimi më të lartë. Nëse përmbajta e tyre në ajrin e mikroambientit aty, arrin në një kufi të caktuar përzierje, shkëndija më e vogël jepë eksplozion.

### 5.2. Ndotja e ujit

Rreziku më potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe ndotja e dheut ndodhë nëse vie deri te shpërthimi i rezervarëve me karburant të vendosur në tokë.

Mundësia e derdhjes së derivateve gjatë mbushjes së rezervarëve dhe gjatë toçitjes së derivateve. Pastaj gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve në sipërfaqet shërbyese për komunikacion vie deri te sedimentimi i materieve ndotëse që është si rezultat i fundërrimit nga gazrat e djegura motorike, i fshirjes së gomave të automjetit, i rrjedhjes së derivateve dhe vajrave nga automjetet e amortizuara, i fundërrimeve nga atmosfera, etj. Vlerat më të larta të ndotjes së ujërave nga sipërfaqet shërbyese të stacionit të karburanteve pritet të jenë gjatë sezonave të dimrit kur kemi hedhjen e kripës nëpër magjistrale, koncentracionet e ndotësve të sedimentuar në platon e stacionit të karburanteve drejtpërdrejt varet nga zgjatja e periodave të thata dhe pa shi dhe nga dendësia e qarkullimit të automjeteve. Përqendrimi i grimcave të suspenduara është proporcional me sasinë e ujërave nga shpërlarja apo nga të reshurat atmosferike ku koncentracionet më të mëdha janë në 5 - 10 min. Ndotje e ujit ndodh nga derdhja e ujërave të ndotura me vajra dhe derivate të përdorura në autolarje për larjen e automjeteve, nga larja e autoparkingut, nga derdhja e ujërave të zeza,

nga derdhja e ujërave të përdorura në kuzhinë dhe lavatriqet për larjen e mbulesave të ndryshme.

### 5.3. Ndotja e tokës

Toka (dheu) si element themelor natyror është kusht ekologjik për rritjen dhe ekzistimin e bimëve, toka është bazë për prodhimin e ushqimit dhe ekzistimin e ekosistemit malor të cilët janë të nevojshëm për arritjen dhe mbajtjen e bilancit ekologjik (produkimit dhe ndërtimit të materieve), posaçërisht për mbajtjen e stabilitetit mjedisor.

Toka është e domosdoshme edhe për funksione teknike në këtë rast për ndërtimin e objektit afarist dhe stacionit të karburanteve.

Gjatë fazës së ndërtimit të stacionit të karburanteve, ndikim negativ në tokë paraqitet në aspektin e humbjes së sipërfaqes pjellore të tokës, mirëpo duke pasur parasysh pozitën ekzistuese të lokacionit që e kemi përmend në pasueset e më sipërme që për momentin për shkak të pozitës kjo tokë nuk punohet dhe krahasimin e përfitimit nga kjo sipërfaqe ky ndikim është i pa përfillshëm, ndikim negativ në tokë paraqitet nga deponimi i dheut të gërmuar të hjekur nga bazamenti, si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen nga materialet ndërtimore gjatë fazës së ndërtimit, mbeturinat e ngurta komunale të cilat i krijojnë punëtorët. Nga pluhurat që lirohen nga sipërfaqet punuese.

Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm, nga mjetet e rënda maqinerike që nevojiten për hjekjen e dheut të bazamenteve dhe ngarkimin e materialit të gërmuar, nga mjetet transportuese që transportojnë materialin ndërtimor.

Në fazën e shfrytëzimit të stacionit të karburanteve ndotja e dheut është si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që vijnë përmes ujërave sipërfaqësore, që vijnë nga sipërfaqja e platosë së stacionit të karburanteve dhe nga autoparkingu, si dhe nga fundërrimet e komponentëve ndotëse nga ajri, kjo ndotje njihet si ndotje sistematike e dheut gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve

pastaj kemi edhe ndotjen aksidentale të dheut e cila vie si pasojë e avarive të mëdha apo të vogla të pajisjeve. Këto ndotje të dheut evitohen vetëm me largimin e dheut të kontaminuar dhe transportimin e tij në vendet e caktuara aty ku nuk rrezikojnë mjedisin.

Nga këto të dhëna vërehet se ndotja e tokës (dheut) afër stacionit të karburanteve varet para se gjithash nga rrjedhja e ujërave të ndotura nga sipërfaqja e platosë së stacionit të karburanteve, konfiguracioni i terenit dhe nga sedimentimi i ndotjeve prej ajrit në rrethinën e stacionit të karburanteve.

### **5.4. Zhurma**

Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin nervor, në hipertension, në koncentrim të njeriut në punë etj.

Lokacioni i stacionit të karburanteve me objektet përcjellëse është i ekspozuar zhurmës së krijuar nga qarkullimi i automjeteve, autocisternave dhe nga funksionimi i pompave dhe kompresorëve për zbrazen dhe shpërndarjen e karburanteve, dhe në mungesë të energjisë elektrike kyçja e shpeshtë e agregatit për energji elektrike.

Sipas gjendjes faktike të kompleksit stacionit të karburanteve në lokacionin e analizuar mundë të konstatojmë se niveli zhurmës i shprehur në dB do të jetë nën vlerën e lejuar prej 60 dB.

### **5.5. Ndikimet në florë dhe faunë**

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mund të vie deri te ndikimet në florë dhe faunë.

Mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar nuk kemi zhdukje të mëdha të vegjetacionit pos nga sipërfaqet nën objekte dhe nën pllantonë e stacionit të karburanteve (edhe pse në këto sipërfaqe nuk ekziston bimësi e mbjellur si kultura bujqësore) pra ndikimi në botën bimëre do të jetë i

vogël, pasi që ky lokalitet është i mbuluar me bazë betoni gjë e cila nuk i ka lënë vend zhvillimit bimor.

E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet që kompleksi i stacionit të karburanteve të ketë ndikime negative në faunën, sepse ajo është larguar nga ky lokalitet me ndërtimin e objekteve biznesore dhe afariste tash përreth në rajonin e ngushtë si dhe më të gjerë.

### **6.0. VLERËSIMI I RREZIKIMIT TË MJEDISIT NGA AKSIDENTET E MUNDSHME**

Me që kemi të bëjmë me Objekte afariste Pikë karburanti ku kemi deponimin dhe distribuimin e karburanteve të lëngët nga ku edhe buron rrezikimi i mjedisit gjatë rasteve aksidentale, kjo qështje trajtohet si e veçantë.

Në rastet e jashtëzakonshme, gjatë derdhjes jo të kontrolluara të karburanteve të lëngët mund të vie deri te aksidentet kimike, intensiteti aksidental i të cilëve mund të jetë i shkallëve të ndryshme. Nga manipulimet e ndryshme vepruese me derivatet e naftës në stacionin e karburanteve mundë të vie deri te rrjedhja apo derdhja e sasive të karburanteve ku nga avullimi i tyre sjell deri te ndotja e ajrit në hapësirën e stacionit dhe hapësirën për rreth tij. Në aspektin teorik aksidentet e një shkalle më të lartë në stacionin e karburanteve mundë ndodhin në rezervuarët me karburante të vendosur në tokë e sidomos gjatë derdhjes (rrjedhjet) si dhe nga auto cisternat.

Të gjitha situatat aksidentale gjatë deponimit dhe distribuimit me derivate të lëngëta mundë të i kategorizojmë në katër grupe:

- Explodimi i avullit të karburanteve që janë në gjendje vlmi
- Explodimi i gazrave të reve të pakufizuara
- Explodimet e kufizuara
- Zjarri

Aksidentin e parë duhet përjashtuar nga analiza sepse për të ardhur deri te ky aksident karburanti në rezervuar duhet të jetë mbi temperaturën e vlimit.

Aksidenti i dytë mund të shkaktohet gjatë manipulimit me benzinë në stacionin e karburanteve ku mund të vie deri te përzierja e avullit të karburanteve me ajrin dhe të krijojnë një përzierje potenciale e cila gjatë koncentracioneve të caktuara dhe energjisë së mjaftuar për aktivizim mundë të shkaktojë detonacion explodues me pasoja të mëdha.

Mundësia e një aksidenti të tillë është shumë e vogël kur kemi parasysh lokacionin e objektit, sasinë e derivateve, dendësinë e automjeteve të cilat furnizohen me derivate, shpejtësinë e avullimit të karburanteve etj.

Në shkallën e detonacionit të një reje nga përzierja e avullit të benzinës dhe ajrit, mjaft ndikon edhe numri i oktanëve të benzinës p.sh. benzina prej 86 apo 98 oktan në vete përmban tetraetil plumbi që është si mjet antidetonues, pastaj me qëllim të ngritjes së numrit të oktanëve benzinës i shtohen edhe hidrokarbure aromatike benzol ( $C_6H_5OH$ ), toluol ( $C_6H_5CH_3$ ) dhe nëse kjo shtesë është mbi 7% atëherë praktikisht është e pamundur të vie deri te një detonacion i reve të përzierjes së avullit të benzinës me ajër.

Mundësia e një explodimi të kufizuar në rezervuarët me karburant në tokë është praktikisht e pamundur kur kemi parasysh faktin se rrjedhja e benzinës nga rezervari në tokë nuk kontakton me ajrin.

Sa i përket zjarrit mund të konstatojmë se realisht është e mundur por nuk do të bëjmë ndonjë analizë detale mbi vlerësimin e rrezikut nga zjarri kur kemi parasysh faktin se do të ekzistoj projekti kundra zjarrit dhe mbrojtja nga zjarri si dhe të gjitha masat preventive që duhet të ndermirren gjatë një aksidenti nga zjarri.

Në rastet e aksidentit nga zjarri në lokacionin dhe rrethinën e stacionit të karburanteve mundë të rrezikohet jeta dhe shëndeti i njeriut si dhe mjedisi rrethues, kur kemi parasysh toksitetin e produkteve të djegëjes (monoksidi i



karbonit dhe formaldehidet), masën e gaztë të produkteve të djegëjes, shkallën e nxehtësisë, produktet jo plotësisht të djegura të derivateve të naftës etj.

Në kuptim më të gjerë, rast aksidental në aspektin e mbrojtjes së mjedisit gjatë manipulimit me derivate të naftës në stacionin e karburanteve është derdhja e derivateve të naftës deri në atë sasi që rrezikon mjedisin, prandaj është e nevojshme që të bëhet sanimi i ndotjes sipas metodave adekuate.

Nëse rregullorja e punës së një stacioni të karburanteve përmban në detale të gjitha aktivitetet dhe veprimet për sanimin e aksidentit nga derdhjet e derivateve, mund të konstatojmë se derdhjet e derivateve të lëngëta nuk mund të rrezikojnë mjedisin.

Në pajtim me nenet e rregullores mbi metodologjinë për vlerësimin e rrezikshmërisë nga aksidenti kimik dhe nga ndotja e mjedisit, masat përgatitore dhe masat për eliminimin e pasojave (EPA) analiza e rrezikshmërisë bëhet në tri faza:

- Identifikimi i rrezikut
- Analiza e pasojave
- Vlerësimi i rrezikut

Identifikimi i rrezikut nënkupton procesin e mbledhjes së të dhënave mbi materiet e rrezikshmërisë në proces si dhe verifikimin e të gjitha pikave kritike të procesit dhe stabilimenteve.

Përveç identifikimit të materieve të dëmshme në proces, në fazën e parë të analizës së rrezikshmërisë duhet bërë identifikimin e burimeve të rrezikut.

### **6.1.1 Analiza e trungut të ngjarjeve**

Ngjarjet të cilat pasojnë në rastet aksidentale mund të kenë karakteristika të ndryshme. Në vijim do të paraqesim disa nga mundësit e zhvillimit të ngjarjeve gjatë aksidentit.

- Reja e formuar lëviz te poshtë:

\*inicimi ndodh menjëherë pas formimit të sferës së nxehtë

\*inicimi ndodh më vonë, krahas shkaktimit të zjarrit ose eksplodimit të resë.

\*nuk vjen deri të inicimi.

- Reja e formuar lëviz përpjetë:

\*inicimi ndodh menjëherë krahas formimit të resë së zjarhtë

\*largohet nga rezervari dhe vjen deri të inicimi ose eksplodimi i resë

\*nuk vjen deri te inicimi.

### 6.1.2. Ngjarja në tërë rezervarin

Në rast se aksidenti e përfshin tërë rezervarin, ekzistojnë dy mundësi:

- a) aksidenti në rezervarin e nxehtë
- b) aksidenti në rezervarin e ftohtë

Inicimet e mundshme në tërë rezervarin janë:

- sfera e zjarrit
- zjarri
- eksplodimi i resë së gaztë dhe
- disperzioni i resë pa inicim

Aksidentin në rezervarin e nxehtë nënkupton veprimin e temperaturave të larta jashtë rezervarit, në këtë rast supozohet se tërë sasia e GLN-së është liruar nga rezervari dhe është djegur si sferë e zjarhtë.


Aksidenti në rezervarin e ftohtë nënkupton avullimin e menjëhershëm dhe formimin e resë së gaztë krahas përzierjes turbulente me ajrin.

### 6.1.3. Aksidenti në pjesë të rezervarit (vrina në rezervar)

Ngjarjet e mundshme në këtë rast janë:

- formimi i resë e cila lëvizë
- inicimi me krijimin e resë së avullit që eksplodon
- shkaktimi i zjarrit
- pa inicim

Reja mund të dispergojë, varësisht nga kushtet aktuale klimatike.



#### 6.1.4. Aksidenti në sistemin shpërndarës

Aksidenti në këtë rast është pasojë e rrjedhjes (derdhjes) së GLN-së nga sistemi shpërndarës dhe mund të çojë deri te:

- flaka kur vjen lëvizja deri te inicimi
- formimi i resë dhe lëvizja e saj me:
  - inicim dhe formim të resë së avullit e cila eksplodon,
  - shkaktim të zjarrit
  - ose nuk ka inicim

#### 6.2. Analiza e pasojave

Analiza e pasojave është faza e dytë e analizës së rreziqeve dhe për qëllim parashikon vëllimin e pasojave të mundshme të aksidentit dhe nivelin e dëmit.

Pasojat kryesore të mundshme të aksidentit në kompleksin e Stacionit të karburanteve janë:

- BLEVE (Biliong Liquid Expanding Vapor Explosions – eksplodimet e avullit ekspandues të lëngut të vluar):

- Zjarri
- Dispergimi i resë pa inicim

### 6.2.1. BLEVE

Masa e BLEVE – së, e cila merret të jetë 80% të vëllimit të rezervuarit. Supozohet se sfera e zjarrit e ka formën sferike dhe është afër tokës. Për rezervarin me vëllim prej  $10\text{m}^3 \times 0.8$  (80% të vëllimit të rezervuarit) diametri i sferës së zjarrit mund të jetë gjerë në 10 m. Kohëzgjatja e sferës është më pak se 10s, në këto rrethana mund të shkaktohen lëndime të djegies se shkallës së tretë në pjesët e zbuluara të lëkurës.

### 6.2.2. Zjarri në rezervar

Zjarri në rezervuar shkakton rrezatim termik, që paraqet rrezik për njeriun dhe për objektet përreth. Për të kuantifikuar efektin e veprimit të zjarrit është përvetësuar që doza e rrezatimit 1000 njësi ( $\text{k}\ddot{\text{E}}/\text{m}^3$ ) shkakton djegie të konsiderueshme në lëkurën e zbuluar të njeriut.

Në tabelën në vijim është dhënë varësia e dozës së rrezatimit nga diametri i zjarrit.

| Diametri                  | Doza (njësi) |
|---------------------------|--------------|
| 1.1 D                     | 3.000        |
| 1.2 D                     | 2.300        |
| 1.3 D                     | 100          |
| 1.4 D                     | 200          |
| (Për njerëzit në objekte) |              |
| Deri në 1.1 D             | 2.300        |
| Mbi 1.1 D                 | 0            |

### 6.3. Vlerësimi i rrezikut

Rreziku nga aksidenti vlerësohet në bazë të gjasave të ndodhjes së aksidentit dhe vëllimit të pasojave.

#### 6.3.1. Vlerësimi i gjasave të ndodhjes së aksidentit

Gjasatë ndodhjes së aksidentit vlerësohen në bazë të dhënave mbi ngjarjet dhe aksidentet në pajisjet (stabilimentet) e njëjta ose të ngjajshme në vendet tjera dhe

të dhënave të përfituara nëpërmjet identifikimeve të rreziqeve. Në tabelën në vijim janë paraqitur gjasat e ndodhjes së aksidenteve sipas të dhënave të publikuara në simpoziumin ICHEME të mbajtur në Budapest në vitin 1991.

| Ngjarja                                | Gjasat         | Distanca (m) |
|----------------------------------------|----------------|--------------|
| Derdhje të vogla                       | Të mëdha       | 10           |
| Çarja e gypave, lidhëseve              | Të vogla       | 10 - 100     |
| Çarja e rezervarit dhe sfera e zjarhtë | Shumë të vogla | Mbi 100      |
| Çarja e rezervarit VCE                 | Tejet të vogla | Mbi 100      |
| Çarja e rezervuarit, formimi i resë    | Tejet të vogla | Mbi 100      |

Sa i përket zjarrit klasik, duhet konstatuar se projekti përkatës i mbrojtjes nga zjarri duhet të kalojë revizionin, kështu që në këtë raport nuk do të analizohet.

### 6.3.2. Vlerësimi i pasojave të mundshme

Pasojat e mundshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mjedisin parashtrihen në bazë të dhënave të përfituara me analizën e cënueshmërisë.

Me anë të analizës së cënueshmërisë evidentohen të gjitha entitetet dhe objektet e cënueshme në rrethinën e burimit potencial të aksidentit:

- të punësuarit në kompleks
- pjesëmarrësit në trafik në rrugë
- objektet afariste dhe të banimit

Siguria aksidentale zvogëlohet pasi rezervari do të vendoset nën tokë dhe i rrethuar me murë statik prej betoni prandaj pasojat e mundshme të aksidentit do të shpreheshin në distancë më të vogël dhe atë deri në 3.5m.

Objektet e banimit janë të larguar mbi 200m, në distancë të largët nga rezervari por, meqë kjo pikë nuk posedon gaz natyror, rrëziu është edhe më i vogël.

### 7.0. MASAT E MBROJTËS SË MJEDISIT

Sipas analizës së bërë mbi ndikimin e stacionit të karburanteve në mjedis, si dhe në bazë të vlerësimit të kompleksit stacionit të karburanteve i cili do të ndërtohet sipas projektit kryesor të ndërtimit dhe rekomandimeve të dhëna në këtë raport, stacioni i karburanteve „**Kijeva Group BSV**” Shpk, në rrugën magjistrale Prishtinë – Pejë në zonën kadastrale Kijevë komuna e Malishevës me veprimtarinë kontinuele të saj në lokacionin e analizuar sipas autorit të raportit nuk rrezikon mjedisin sepse janë realizuar shumë nga parakushtet e nevojshme për mbrojtjen adekuate të mjedisit, por megjithatë duhet të parashihet që në rast se vie deri te ndotja duhet të ndermirren masat për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative që shpijnë deri te rrezikimi i mjedisit jetësor. Me qëllim të zvogëlimit të mëtejme të ndikimeve potenciale negative në mjedis, rekomandohet ndërmarrja e masave të cilat bëjnë pjesë në domenin e menaxhimit të rrezikut në Objektin e stacionit të karburanteve në rrethanat e jashtëzakonshme dhe të rregullta.

#### 7.1. Masat për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër gjatë fazës së ndërtimit të stacionit të karburanteve me infrastrukturën përcjellëse duhet të merren këto masa:

##### *Faza e ndërtimit*

Gjatë punës me makina ngarkuese dhe transportuese të gjitha sipërfaqet manipuluese të stërpikën me ujë posaçërisht në kohra me erëra dhe temperatura të larta.

Duhet të behët kontrollimi i rregullt teknik i makinave ngarkuese dhe transportuese që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetet e punës të jetë sa më kualitativ.

### *Faza e zhvillimit të aktivitetit*

Gjatë fazës së kryerjes së aktiviteteve në stacionin e karburanteve për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajrë nga avullimi i karburanteve duhet marrë këto masa mbrojtëse:

Të gjithë gypat ajrues të rezervarëve duhet të vendosen në lartësi të nevojshme. Stacioni i karburanteve duhet të pajiset me sistemin për mbledhjen e avujve që lirohen nga karburantet.

Me qëllim të zvogëlimit të ndotjes së ajrit e cila ndodhë si produkt i aromës së keqe që lirohet nga hapësirat e kuzhinës duhet të bëhet ventilimi i hapësirave të kuzhinës dhe restorantit për pastrimin e ajrit, gjithashtu aroma e pakëndshme do të zvogëlohet përmes ajrimit artificial përmes dritareve të vendosura në objekt.

### **7.2. Masat mbrojtëse të ujërave**

Edhe pse stacioni i karburanteve të kompanisë „**Kijeva Group BSV**” Shpk, në rrugën magjistrale Prishtinë-Pejë në zonën kadastrale Kijevë komuna e Malishevës, nuk do të zhvilloj një afarizëm të madh që të gjenerojë ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore, e pastaj edhe të ujërave nëntokësore, por ndotja ndodh si që e kemi përshkruar në pasuset e mësipërme.

Në kompleksin e stacionit të karburanteve duhet bërë sistemin për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura nga sipërfaqet manipulative, nga hapësirat e stacioni të karburanteve, nga parkingu i automjeteve dhe të dërgohen në seperator për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura. Në kompleksin e stacionit të karburanteve duhet të ndërtohet separatori për vajra me kapacitet minimal prej 15 m<sup>3</sup> sipas përshkrimit të bërë në projektin kryesor për ndërtimin e stacionit të karburanteve dhe sipas vizatimit të paraqitur në planin e situacionit.

Seperator do të ndërtohet sipas standardeve në hapësirën që shihet në planin e situacionit që ia bashkangjesim raportit të VNM-së. Seperator për mes mureve në disnivele e bënë ndarjen (seperimin) e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura dhe i deponon në pusëtën e posaçme, ku pas mbushjes së pusëtës duhet



të pastrohet nga ndërmarrjet e licencuara për pastrimin e seperatorve. Seperator duhet të përmbush kriteret teknike që janë të parapara me rregullore dhe normative në fuqi. Seperator duhet të rregullohet në atë mënyrë që të mundë të kontrollohet rregullisht uji i cili pastrohet dhe të merren mostrat e ujit i cili pastrohet. Duhet të ndërtohet gropa septike për trajtimin e ujërave të zeza e pastaj pas gropës septike ujërat e trajtuara të dërgohen në bunarin filtrues. Ujërat e trajtuara në seperator dërgohen në bunarin filtrues.

Ujërat e të reshurave atmosferike nga sipërfaqet e kulmeve të grumbullohen dhe të derdhën në gropën septike.

Preferohet të vendoset edhe një seperator për trajtimin e ujerave të ndotur nga kuzhina dhe lavatriqet e rrobeve. Seperatorët për trajtimin e ujërave të ndotura nga kuzhina janë të ndërtuar sipas standardeve Din 4040 dhe Din 4041.

Efektet e largimit të yndyrave janë gjerë në 92%. Madhësia dhe dimensionet e seperatorve caktohen në bazë të numrit të racioneve të përgatitura gjatë ditës, gjerë në 400 racione preferohet seperatori me kapacitet 2 l/sec. Për çdo 100 racione kapaciteti i seperatorit rritet për 0.5 l/sec. Për çdo lavatriqe për larjen rrobave kapaciteti i seperatoreve rritet për 1 l/sec. Konstruksioni i seperatorve nëse vendoset në objekt ndërtohen nga alumini, seperatorët që vendosen jashtë objektit ndërtohen nga çeliku kualitativ jo korodues.

Në tabelën në vijim po i japim parametrat dhe dimensionet e disa seperatorve standard.

| Seperator  | Gjatsia | Gjersia | Lartësia | Lartësia e | Hyrja  | Dalja  | Gypi | Rrjedhja |
|------------|---------|---------|----------|------------|--------|--------|------|----------|
| Volumi (l) | L (mm)  | B (mm)  | H (mm)   | Përgji. h  | H (mm) | D (mm) | ØD   | Q (l/s)  |
| 800 l      | 1500    | 750     | 800      | 1300       | 620    | 675    | Ø100 | 1,5      |
| 1200 l     | 1500    | 850     | 1000     | 1500       | 620    | 675    | Ø100 | 2,2      |
| 2000 l     | 2000    | 1000    | 1100     | 1600       | 635    | 700    | Ø100 | 3,0      |
| 2500 l     | 2500    | 1000    | 1200     | 1700       | 670    | 750    | Ø125 | 6,0      |
| 3500 l     | 2750    | 1100    | 1200     | 1950       | 910    | 990    | Ø150 | 10,0     |

|         |      |      |      |      |      |      |      |      |
|---------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| 5000 l  | 3000 | 1250 | 1300 | 2050 | 950  | 1050 | Ø200 | 20,0 |
| 6000 l  | 3500 | 1300 | 1350 | 2100 | 1000 | 1125 | Ø250 | 30,0 |
| 10000 l | 4500 | 1500 | 1500 | 2250 | 1000 | 1125 | Ø300 | 40,0 |
| 20000 l | 6000 | 2000 | 2000 | 2750 | 1115 | 1270 | Ø300 | 80   |

Ujërat nga separatori nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë derivate të naftës mbi 1 mg/l dhe materie të suspenduara mbi 30mg/l në ujë. Pronari i Objektivit afarist dhe stacionit të karburanteve „**Kijeva Group BSV**” Shpk, në rrugën magjistrale Prishtinë – Pejë në zonën kadastrale Kijevë komuna e Malishevës, duhet të e bëjë matjen e cilësisë të ujit të shkarkuar nga separatori i vajrave, vlerat e fituara do të krahasohen dhe nuk guxojnë të jenë më të larta se vlerat e caktuara si pas Udhëzimit administrativ Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.

### 7.3. Masat për mbrojtjen e tokës

Përpos masave të përshkruara më lartë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të mundshme të përshkruara në pasusët e mësipërme duhet të i ndërmerren masat në vijim.

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së ndërtimit të stacionit të karburanteve duhet të merren këto masa: Dheu i grupuar duhet të shfrytëzohet për rrafshimin dhe planifikimin e terrenit i cili duhet të mbillet, pjesa tjetër e dheut duhet të dërgohet në deponin regjionale. Si masë tjetër për mbrojtjen e tokës rekomandohet që në kohëra kur ka të reshura atmosferike të mos punohet me makina të rënda, me qëllim të mos ngjeshjes në masë të madhe të tokës. Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen nga materialet ndërtimore duhet të klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, dhe të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren dhe shitën për nevoja komerciale duhet të dërgohen në deponin regjionale. Mbeturinat e ngurta

komunale të grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, kontejnerët duhet të sigurohen për deponimin e të gjitha llojeve të mbeturinave të klasifikuara ne bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj për Mbeturina Nr. 04/L-060, pas mbushjes së kontejnerëve përmes ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin e qytetit. Vaji i makinave ngarkuese dhe transportuese që nevojiten për ndërtimin e stacionit të karburanteve të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë, vajrat duhet të deponohen në enë të posaçme, dhe pastaj të u dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

Gjatë fazës së kryerjes së aktiviteteve në stacionin e karburanteve për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë duhet marrë këto masa mbrojtëse:

- Për mbrojtjen e tokës nga ndikimet negative tëra hapësirat operationale në të cilat bëhet manipulimi me karburante si dhe auto parkingu duhet të mbulohen me beton ose asfalt.
- Furnizimi me ujë për pije si dhe për nevoja tjera sanitare do të bëhet nga sistemi i ujësjellësit, kurse furnizimi i ujit që shfrytëzohet për larjen e platos manipuluese, për ujitje të sipërfaqeve gjelbëruese, për pajimet për zjarrfikje do të bëhet nga pusi i thellë që duhet hapur nga pronari.
- Të gjitha ujërat atmosferike dhe ujërat të përdorura nga sipërfaqet me ndikim të mundshëm duhet të grumbullohen me kolektor dhe nëpërmjet gypave të përcjellën në separator të vajrave.
- Ujërat fekale nga nyjet sanitare përmes gypave duhet të dërgohen në gropën septike ose në kanalizimin e qytetit.
- Duhet rregullisht të bëhet kontrollimi i separatorit të vajit, pas mbushjes duhet berë pastrimin e tij, fundërrina dhe vaji duhet të deponohen në enë të posaçme dhe pastaj të dërgohen në trajtim të mëtejshëm sipas ligjit për trajtimin e materieve të rrezikshme.

- Duhet të vendosen kontejnerët adekuat të pajisur me kapak për deponimin e mbeturinave komunale, pas mbushjes së tyre duhet të dërgohen për zbrazje ne deponin regjionale.
- Duhet të vendosen enët adekuate për deponimin e mbeturinave të lënget.
- Duhet të bëhet mbjellja e sipërfaqeve dhe oazave të pa betonuara dhe të pa asfaltuara me barë dhe drunj dekorativ me qëllim të pastrimit të ajrit nga ndotjet me gazra, dhe për çështje vizuale.

#### **7.4. Masat mbrojtëse në rezervar**

Rezervarët për lëndë djegëse të lëngtë do të prodhohen sipas standardeve të caktuara dhe do të vendosen po ashtu sipas standardeve.

- Të gjithë gypat ajrues të rezervarëve do të vendosen në lartësi të sigurt.
- Është obligim permanent i punëtorëve që të kontrollojë sistemin e gypave me mekanizëm për mbushje dhe zbrazje të karburanteve nga rezervarët.
- Është obligim që rezervarët e karburanteve të kontrollohen brenda 5 viteve të para të punës për të përcjell dëmtimet e trashësisë së mureve nga veprimi korroziv, pas 5 viteve, kontrolli duhet bërë për çdo dy vite.

#### **7.5. Masat mbrojtëse në sistemin shpërndarës**

- Është obligim që mekanizmi i sistemit shpërndarës dhe rezervarët të pajisen me elementin detektues të derdhjes eventuale të karburanteve të lëngta.
- Sistemi i gypave shpërndarës me automatë për karburante të lëngëta dhe të gazta duhet siguruar që të pengohet derdhja eventuale e karburanteve.
- Stacioni i karburanteve duhet të pajiset me sistemin sekondar për mbledhjen e derdhjeve aksidentale.
- Stacioni i karburanteve duhet të pajiset me sistemin për mbledhjen e avujve që lirohen gjatë toçitjes nga karburantet.

### 7.6. Rekomandimet tjera për evitimin e rrezikut dhe mbrojtje të mjedisit

- Të bëhet përdorim i drejt, mbikëqyrje e rregullt dhe mirë mbajtje e pajisjeve.
- Të hartohet rregullorja ku do të definohen procedurat për rastet aksidentale, të bëhet aftësimi i të punësuarve dhe të caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale.
- Duhet të ndërtohet sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe të sigurohen aparatet me mjete kimike si dhe enët me rërë.
- Në mënyrë permamanente të mirëmbahet ambienti në kompleksin e stacionit të karburanteve e posaçërisht nyja sanitare, platoja me rrethin dhe gjelbërimi rrethues.
- Duhet të sigurohen dhe të jenë në disponim pajisjet doracake kundër shkëndijave.
- E tërë sipërfaqja e kompleksit të stacionit të karburanteve duhet të rrethohet me tel gjembor dhe ku është nevoja edhe me mur statik.
- Të shtohen hapësirat gjelbëruese përreth objekteve, sipas kushteve të ndërtimit.
- Të përdoret sistemi i ujitjes gjatë tërë kohës për minimizimin e grimcave të pluhurit, sidomos gjatë verës.
- Përreth perimetrit të objektit dhe rezervuarve të naftes duhet të ndërtohen kanalet drenazhues për ujërat atmosferike.
- Kujdes i veçantë do të tregohet në krijimin e kushteve të punës sa më komforte për punonjësit.
- Të menagjohen mbeturinat nga stacioni i karburanteve dhe nga lokali i cili është i paisur gjera ushqimore (minimarket).
- Të rriten normat e sigursë në ambientin e punës te pompa e benzinës.
- Të menjahen rrjedhjet eventuale të derivateve rreth pompës.
- Të sigurohet edhe sistemi i aparateve kundër zjarrit dhe të trajtohen punëtorët për përdorimin e tyre.

### 8.0. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Investitori është i obliguar që të bëjë monitorimin e përhershëm të ndikimeve negative në mjedis e posaçërisht monitorimin e tokës, ajrit dhe zhurmës. Këto ndikime mund të jenë relativisht minimale në mjedis pas marrjes së masave mbrojtëse, dhe si të tilla mund të monitorohen. Për këtë arsye parashihet një program monitorues për degradimet e tokës, kualitetin e ajrit dhe ujit. Duhet të bëhet matja e kualitetit të ajrit (matja e emisioneve) dhe zhurmës gjatë punës maksimale të pajimeve, matja duhet bërë të shtëpitë më të afërta. Monitorimi i ajrit dhe ujit duhet të bëhet me marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në institute të akredituara për llojin e analizës. Të bëhet kontrollimi i përhershëm i seperatorve si dhe i gropës septike, dhe zbrazja e tyre të bahet me kohë. Kontejnerët e mbeturinave të zbrazën rregullisht. Të respektohen të gjitha rregullat teknike dhe kërkesat lidhur me sigurinë ndaj zjarrit, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Raportimi do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor, përkatësisht lejen mjedisore të lëshuara nga MMPHI.

### 9.0 MARJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITET

Në rast të përfundimit të qdo aktiviteti parashihet që e tërë hapësira përkatësisht habitatit të kthehet gjendjes normale siç ka qenë e kjo normalisht varet nga nevojat e konsumatorëve si dhe nga interesi i vetë pronarit të këtij biznesi, pa harruar faktin që edhe nëse përfunon ky aktivitet pronari i objektit është i obliguar të largoj paisjet që i kanë shërbyer për realizimin e veprimtarisë. Por nëse pronari vendos të largoj edhe objektin atëherë të gjitha paisjet duhet të largohen nga objekti, eventualisht kalojnë në ndonjë objekt tjetër apo varësisht nga lavërdia

mund edhe të shiten si material i vjetruar. Bazamentet si dhe platot nga betoni të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi rajonale. Pas largimit të objektit mund të krijohet një terren i përshtatshëm për rikultivim, andaj duhet të bëhet zëvendësimi i tij me një substrat më produktiv dhe i përshtatshëm për rikultivim. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit.

Qëllimi i rekultivimit i cili nënkupton që pas përfundimit të punëve të këtij aktiviteti, sipërfaqeve të degraduara, prapë t'u kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem. Duhet bërë edhe planifikimi që toka në lokacionin e vendndodhjes së objektit në fjalë të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues. Qëllimi i rikultivimit biologjik është që të krijojmë ekosistem të ri në hapësirat e dëmtuara në të cilën do të krijohet barazpeshë relative e të gjitha elementeve të ekosistemit siç janë: toka, flora, fauna. Rikultivimi biologjik është faza përfundimtare me të cilën arrihet edhe qëllimi i rikuperimit.

### **10.0 Kontrolli i emisioneve pas përfundimit të aktivitetit**

Me përfundimin e aktivitetit të objektit afarist stacionit të karburanteve dhe rehabilitimit të ngastrave për qëllime tjera, nuk është e nevojshme dhe nuk parashihet monitorimi i ajrit, ujit dhe tokës apo ndikimet tjera në mjedis. Kompania e cila e ka operuar në atë vend, ka për detyrë të bëjë monitorimin e sipërfaqeve të rekultivuara, posaçërisht pjesës së pyllëzuar për një kohë të caktuar.



### 11.0. PËRFUNDIM

Ndikimi i objektit afarist pompë e derivateve me etazhet P+0 në mjedis do të jetë në nivelin e vlerave të standardeve të caktuara me ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme.

Ndikimi në tokë, ajër dhe ujë mund të kontrollohen, ndikimet do të monitorohen dhe do të raportohet në fund të çdo viti kalendarik dhe sipas kërkesës së MMPHI. Bazuar në informacionet që kemi marrë rreth planifikimit të realizimit të këtij projekti e të cilat mund të ndikojnë në mjedisin jetësor, dhe duke i'u përshtatur ligjeve për mbrojtën e mjedisit dhe udhëzimeve administrative, projekti në fjalë mund të realizojë veprimtarinë e planifikuar si pikë karburanit me objekte përcjellëse. Ky projekt ka kapacitet mesatar të rezervuarëve për lëndë djegëse të lëngëta dhe objekt afariste si minimarket, andaj mund të konkludojmë së ndërtimi dhe funksionimi kontinual i stacionit të karburanteve i kompanisë „**Kijeva Group BSV**” Shpk, në rrugën magjistrale Prishtinë–Pejë në zonën kadastrale Kijevë komuna e Malishevës, nuk shkakton ndikime negative në mjedis dhe nuk rrezikon shëndetin e njeriut. Gjithashtu ndikimet në tokë, ujë, ajër dhe peizazh, pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport, konstatojmë se ato mund të zvogëlohen në nivel të lakmueshëm, edhe të eliminohen tërësisht në fazën e rehabilitimit të hapësirave të degraduara gjatë ndërtimit dhe realizimit të projektit.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme dhe i mundësojnë Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhënien e mendimit për **Pëlqim Mjedisor** për objektit afarist pompë e derivateve me etazhet P+0 „**Kijeva Group BSV**” Shpk, në magjistralen Prishtinë–Pejë, zona kadastrale Kijevë komuna Malishevë, sipas kërkesës të investitorit dhe pronarit të kompanisë **z. Besim Ukaj**.

## 12.0 LITERATURA

1. Plani Zhvillimor Komunal i komunës së Malishevës 2019 - 2027
3. MMPH (2013): Legjislacioni mjedisor në Kosovë 2007-2013 (Vëllimi I). Prishtinë.
4. MMPH-AKMM (2008): Raport i gjendjes së mjedisit 2006-2007. Prishtinë.
5. MMPH-AKMM –IKMN (2008): Raport i gjendjes së natyrës 2006-2007. Design House. Prishtinë.
6. MMPH-AMMK (2010): Gjendja a Natyrës-Raport 2008-2009. UNDP. IN Design. Prishtinë.
7. MMPH-IHMK – Buletini Hidro-Klimatologjik 2016,
8. MMPH\_IHMK – Resurset Ujore te Kosves 2015,
9. MMPH-IHMK – Vjetari Hidrometeorologjik 2014,
10. mmph-rks.org/Ligjet 15. Osmani, J. (2008): Vendbanimet e Kosovës.

## Shtojcë

### ***Bashkëngjitur këtij raporti gjeni:***

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit
- Çertifikatat mbi të drejtat e pronës
- Kopja e planit të ngastrave
- Plani i situacionit
- Pëlqimi nga AME
- Pëlqimi për kyqje në rrugë
- Leja ndërtimore